



2077  
26.02.2024

REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI BASHKIAK ELBASAN

Nr 1045/1 Prot

Elbasan më 23 /02/2024

**VENDIM**

Nr 9 datë 23 /02/2024.

**Mbi dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi i Bashkisë për muajin JANAR 2024**

Mbështetur në ligjin nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, ligjin nr. 57/2019 “Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë”, V.K.M nr. 597, datë 04.09.2019 “Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesëmbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike”, si dhe bazuar në kriteret e VKB nr 10 datë 20.02.2023 “Mbi miratimin e kriterëve të dhënies së ndihmës ekonomike nga fondi i Bashkisë”

**VENDOSI**

1. Të përfitojnë ndihmë ekonomike nga fondi i të ardhurave të bashkisë për muajin JANAR 2024, 79 familje me fond 230.470 lekë.
2. Masa e pagesës për të gjitha familjet përfituese të jetë konform V.K.M nr. 597, datë 04.09.2019 “Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike” paragrafi IV pika 11.
3. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi Drejtoria e Shërbimeve Sociale dhe Drejtoria e Financës.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Sekretar i Këshillit Bashkiak  
Elvi Çuni

Kryetari i Këshillit Bashkiak  
Lutfi Lala

1045/2  
27.02.2024



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
PREFEKTI I QARKUT ELBASAN  
SEKTORI FINANCIAR DHE SHËRBIMET MBËSHTETËSE

Nr. 287/1 Prot

Elbasan, më 27.2.2024

Lënda: Konfirmim akti

**KËSHILLIT TË BASHKISË ELBASAN**

Në zbatim të nenit 16 të ligjit nr.107/2016 "Për Prefektin e Qarkut", pasi u kontrollua ligjshmëria e aktit tuaj nr.9, datë 23.02.2024 " Mbi dhënien e ndihmës nga fondi i Bashkisë për muajin Janar 2024", konfirmojmë në parim mbështetjen e tij në ligj.

**PREFEKTI**  
**Majlinda PERRIU**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI BASHKIAK ELBASAN

Nr 1043/1 Prot

Elbasan më 23/02/ 2024

**VENDIM**

Nr. 10 datë 23 /02/2024

**Mbi dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar për muajin JANAR 2024**

Mbështetur në ligjin nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, nenin 21 të ligjit nr. 57/2019 “Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë”, V.K.M nr. 597, datë 04.09.2019 “Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike”, si dhe bazuar në kriteret e VKB nr. 11 datë 20.02.2023 “Mbi miratimin e kriterëve të dhënies së ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar për bllok-ndihmën ekonomike”

**V E N D O S I**

1. Të përfitojnë ndihmë ekonomike nga fondet e kushtëzuara për muajin JANAR 2024 gjithsej 191 familje me një fond prej 828.601 lekë.
2. Masa e pagesës për të gjitha familjet përfituese të jetë konform V.K.M nr. 597, datë 04.09.2019 “Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike” paragrafi IV pika 11.
3. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi Drejtoria e Shërbimit Social dhe Drejtoria e Financës.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Sekretari i Këshillit Bashkiak  
Elvi Çuni

Kryetari i Këshillit Bashkiak  
Lutfi Lala



1043/2  
27.02.2024



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
PREFEKTI I QARKUT ELBASAN  
SEKTORI FINANCIAR DHE SHËRBIMET MBËSHTETËSE

Nr. 2881 Prot

Elbasan, më 27.2.2024

Lënda: Konfirmim akti

KËSHILLIT TË BASHKISË ELBASAN

Në zbatim të nenit 16 të ligjit nr.107/2016 “Për Prefektin e Qarkut”, pasi u kontrollua ligjshmëria e aktit tuaj nr.10, datë 23.02.2024 “ Mbi dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar për muajin Janar 2024”, konfirmojmë në parim mbështetjen e tij në ligj.

PREFEKTI  
Majlinda PERRIU





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI BASHKIAK ELBASAN

Nr 1042/1 Prot

Elbasan më \_\_\_/02/ 2024

**VENDIM**

Nr. 12. datë 23 /02/2024

**Mbi miratimin e kritereve të dhënies së Ndhimës Ekonomike nga fondi i kushtëzuar për bllok-ndihmën ekonomike**

KËSHILLIT BASHKIAK

Këshilli Bashkiak në mbledhjen e tij të datës 23 /02/2024 pasi shqyrtoi relacionin e paraqitur nga Drejtoria e Shërbimeve Sociale , bazuar në ligjin nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, në nenin 21 të ligjit nr. 57/2019 “Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë” në pikën 1,2,3 të kreut IV të VKM nr. 597, datë 04.09.2019 “Për përcaktimin e procedurave, dokumentacionit dhe masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike”

**VENDOSI**

- I. Të miratojë kriteret per dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar për bllok-ndihmën si më poshtë:
  1. Familje të varfëra të cilat nuk janë shpallur përfituese nga sistemi i pikëzimit .
  2. Familje me kryefamiljare femra në vështirësi ekonomike dhe sociale të cilat nuk janë shpallur përfituese nga sistemi i pikëzimit .
  3. Familje që kanë në përbërje anëtarë mbi moshë pune, por që nuk perfitojne pension pleqërie të cilat nuk janë shpallur përfituese nga sistemi i pikëzimit .
  4. Familje me shumë fëmijë të cilat nuk janë shpallur përfituese nga sistemi i pikëzimit .
- II. Dokumentat e aplikuesve të jenë të njëjta sipas VKM nr 597 datë 04.09.2019 “Për përcaktimin e procedurave, dokumentacionit dhe masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmen ekonomike “
- III. Masa e ndihmës ekonomike përllogaritet nga Shërbimi Social Shtetëror sipas VKM nr 597 datë 04.09.2019 “Për përcaktimin e procedurave, dokumentacionit



dhe masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmen ekonomike”

- IV. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi Drejtoria e Shërbimit të Kujdesit Social dhe Komunitar si dhe Drejtoria e Financës.
- V. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas miratimit në Këshillin Bashkiak.

**Sekretari i Këshillit Bashkiak**  
**Elvi Çuni**

**Kryetari i Këshillit Bashkiak**  
**Lutfi Lala**



1042/3  
27.02.2024



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
PREFEKTI I QARKUT ELBASAN  
SEKTORI FINANCIAR DHE SHËRBIMET MBËSHTETËSE

Nr. 290/1 Prot

Elbasan, më 27.2.2024

Lënda: Konfirmim akti

KËSHILLIT TË BASHKISË ELBASAN

Në zbatim të nenit 16 të ligjit nr.107/2016 “Për Prefektin e Qarkut”, pasi u kontrollua ligjshmëria e aktit tuaj nr.13, datë 23.02.2024 “ Mbi miratimin e kriterëve së dhënies së Ndhmës Ekonomike nga fondi i kushtëzuar për bllok-ndihmën ekonomike”, konfirmojmë në parim mbështetjen e tij në ligj.





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI BASHKIAK ELBASAN

Nr. 1044/1 prot

Elbasan më 23 2024

VENDIM  
Nr. 11 datë 23/02/2024

**Mbi miratimin e kritereve të dhënies së Ndhmës Ekonomike nga fondi i Bashkise**

Këshilli Bashkiak në mbledhjen e tij të datës 23/02/2024 pasi shqyrtoi relacionin e paraqitur nga Drejtoria e Shërbimit të Kujdesit Social dhe Komunitar, bazuar në ligjin nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, në nenin 21 të ligjit nr. 57/2019 “Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë” në pikën 3 të kreut IV të VKM nr. 597, datë 04.09.2019 “Për përcaktimin e procedurave, dokumentacionit dhe masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmen ekonomike”

**VENDOSI**

- I. Të miratojë kriteret për dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi i Bashkisë si më poshtë:
  1. Familje të varfëra të cilat nuk janë shpallur përfituese nga sistemi i pikëzimit,
  2. Familje shumë të varfëra që për shkaqe sociale nuk arrijnë të aplikojnë sipas VKM nr. 597 datë 04.09.2019 “Për përcaktimin e procedurave, dokumentacionit dhe masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmen ekonomike”
  3. Familje të varfëra me një bashkëshort të larguar (apo në burg) dhe që nuk mund të fillojnë procedurat e divorcit, apo nuk sigurojnë dokumentat përkatës.
  4. Familje me probleme të tjera sociale.
- II. Dokumentat e aplikuesve të jenë: Çertifikate familjare, fotokopje e kartës së identitetit, formulari i paraqitjes mujore, raporti (formulari) i përshkrimit të gjendjes social-ekonomike të familjes nga Administratori Shoqëror, dokument i statusit si punëkërkuar i



papunë nga AKPA ,dokument pronësie si dhe dokumente të tjera plotësuese për dosjen e familjes që trajtohet me ndihmë ekonomike nga të ardhurat e Bashkisë.

- III. Masa e ndihmës ekonomike të llogaritet sipas VKM nr. 597 datë 04.09.2019 “Për përcaktimin e procedurave, dokumentacionit dhe masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmen ekonomike”
- IV. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi Drejtoria e Shërbimeve Sociale dhe Drejtoria e Financës.
- V. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas miratimit në Këshillin Bashkiak.

**Sekretar i Këshillit Bashkiak**  
**ELVI ÇUNI**

**Kryetar i Këshillit Bashkiak**  
**Lutfi Lala**



1044/2  
27.02.2024



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
PREFEKTI I QARKUT ELBASAN  
SEKTORI FINANCIAR DHE SHËRBIMET MBËSHTETËSE

Nr. 289 / Prot  
/

Elbasan, më 27. 2.2024

Lënda: Konfirmim akti

KËSHILLIT TË BASHKISË ELBASAN

Në zbatim të nenit 16 të ligjit nr.107/2016 “Për Prefektin e Qarkut”, pasi u kontrollua ligjshmëria e aktit tuaj nr.11, datë 23.02.2024 “ Mbi miratimin e kriterëve të Ndhmës Ekonomike nga fondi i Bashkisë”, konfirmojmë në parim mbështetjen e tij në ligj.

PREFEKTI  
Majlinda PERRIU





REPUBLIKA E SHQIPERISË  
BASHKIA ELBASAN  
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 1054/1 Prot.

Datë 23 .02. 2024

VENDIM

NR. 13 DATË 23 .02. 2024

MBI

**“Raporti i monitorimit të buxhetit për 4-mujorin e tretë (janar-dhjetor) të vitit 2023”**

Këshilli Bashkiak në mbledhjen e tij të datës 23 .02.2023, pasi mori në shqyrtim materialin e paraqitur nga Bashkia Elbasan mbi **“Raporti i monitorimit të buxhetit për 4-mujorin e tretë (janar-dhjetor) të vitit 2022”**, bazuar në ligjin nr.139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, ligjin nr.9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, ligjin nr.68/2017, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, neni 48, pika 1, udhëzimin e Ministrisë së Financave nr.22, date 30.07.2018 “Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit të njëjësive të vetëqeverisjes vendore”,

VENDOSI

1. Të miratojë “Raportin e monitorimit të buxhetit për 4-mujorin e tretë të vitit 2023 (janar-dhjetor)”, për Bashkinë Elbasan, sipas materialit bashkëngjitur.
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet administrata e Bashkisë.
3. Ky vendim hyn në fuqi 10 dite pas shpalljes së tij.

SEKRETAR  
Elvi Cuni

KRYETAR  
Lutfi Lala

Dr.Buxhet Fin.: A.Merkja  
D.P.P.A.B.F: Q.Tusha  
D.P.P. Zh. U : D.Meta  
D.P. Sh. O : G.Dyrmyshi  
D.P.Sh.I.P.P : S.Mehmeti  
D.P.P.S.S.Sh : E.Muço  
D.ABNJ : L.Dervishi  
Dr.Juridike: A.Hoxha  
Zv/kryetar : A.Bylykbashi



1054/2  
04.03.2024



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
PREFEKTI I QARKUT ELBASAN  
SEKTORI FINANCIAR DHE SHËRBIMET MBËSHTETËSE

Nr. 308/1 Prot

Elbasan, më 5.3.2024

Lënda: Konfirmim akti

KËSHILLIT TË BASHKISË ELBASAN

Në zbatim të nenit 16 të ligjit nr.107/2016 “Për Prefektin e Qarkut”, pasi u kontrollua ligjshmëria e aktit tuaj nr.13, datë 23.02.2024 “Raporti i monitorimit të buxhetit për 4-mujorin (janar-dhjetor) të vitit 2023”, konfirmojmë në parim mbështetjen e tij në ligj.




PREFEKTI  
Majlinda PERRIU

**BASHKIA ELBASAN**

**RAPORT MONITORIMI  
BUXHETI 2023**

**PROGRESIV 4- MUJORI III-të (vjetor)**



**SHKURT 2024**

Përmbajtja:

Buxheti i Bashkisë për vitin 2023 (progresiv 4 Mujori i III-të)

Realizimi i të ardhurave të Bashkisë nga burimet e veta vendore për vitin 2023 (progresiv 4 Mujori i III-të)

Realizimi i buxhetit për vitin 2023 (progresiv 4 Mujori i III-të)

- F1. Funksioni “Shërbime të përgjithshme publike”
- F2. Funksioni “Shërbime të huamarrjes vendore”
- F3. Funksioni “Rendi dhe siguria publike”
- F4. Funksioni “Çështje ekonomike”
- F5. Funksioni “Mbrojtja e mjedisit”
- F6. Funksioni “Strehimi dhe komoditetet e komunitetit”
- F7. Funksioni “Shëndetësia”
- F8. Funksioni “Argëtimi, kultura dhe feja”
- F9. Funksioni “Arsimi”
- F10. Funksioni “Mbrojtja Sociale”

## I. BUXHETI I BASHKISË PËR VITIN 2023 (progresiv 4 mujori i III-të)

Detajimi i buxhetit për vitin 2023 është bërë bazuar në ligjin Nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore“, ligjin Nr.9936, datë 26.06.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, ligjin nr.10296, date 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin, ligjin 68/2017, datë 27.4.2017 “Per financat e veteqeverisjes vendore“, ligjin Nr. 84/2022, “Për buxhetin e vitit 2023“ si dhe VKB nr. 190, datë 27.12.2022 “Për miratimin e buxhetit të Bashkise Elbasan per vitin 2023.

Programi Buxhetor i vitit 2023 parashikon një mbulim sa më të plotë të territorit me shërbime publike cilësore me qëllim përmirësimin e jetesës së qytetarëve; përmirësimin dhe modernizimin e infrastrukturës rrugore urbane dhe asaj rurale; përmirësimin e shërbimit të pastrimit në të gjithë territorin, rritjen e sipërfaqeve të gjelbërta; mirëmbajtjen e tregjeve të reja; përmirësimin e infrastrukturës turistike dhe aksesit; mbështetjen e iniciativave për zhvillimin e zonave të përmirësimit të biznesit; mbrojtjen e tokave bujqesore, rehabilitimin dhe investimin e infrastrukturës bujqësore; mbrojtjen e mjedisit, ruajtjen dhe përmirësimin e tij; sigurimin e kushteve sa më dinjitoze për fëmijët dhe të rinjtë; mbulimin e territorit me shërbime sociale sipas nevojave të komunitetit; zhvillimin e aktiviteteve kulturore dhe sportive; sigurimin e mbrojtjes civile dhe menaxhimin e katastrofave në të gjithë territorin e Bashkisë Elbasan.

Zbatimi i Buxhetit të vitit 2023 është një instrument i rëndësishëm për përmirësimin e cilësisë së jetës, përmirësimin e aksesit, integrimin territorial dhe barazinë në shërbime, zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik, rritjen e cilësisë së jetesës dhe mbrojtjen e mjedisit duke e kthyer Elbasanin në një qendër të përparuar social-ekonomike.

Ky dokument ka përcaktuar 27 programe (21 programe që përdorin njësitë e vetëqeverisjes vendore dhe që janë pjesë e buxhetit të Bashkisë Elbasan dhe 6 programe i takojnë fondeve nga trasfertat e kushtëzuara) dhe një seri funksionesh dhe aktiviteteve respektive për çdo funksion, prandaj është treguesi më i mirë se si shpenzimet e planifikuara lidhen me veprimtaritë dhe projektet e planifikuara si dhe me Strategjinë e Zhvillimit që i mbështet këto projekte.

Bashkia Elbasan, administron dhe menaxhon fondet, sipas 27 programeve të miratuara, si më poshtë:

1. Programi “Planifikim, Menaxhim & Administrim”
2. Programi “Shërbimet e Gjendjes Civile”
3. Programi “Shërbime të Policisë Vendore”
4. Programi “Mbrojtja nga zjarri dhe mbrojtja civile”
5. Programi “Mbeshtetje per zhvillimin ekonomik”
6. Programi “Shërbimet bujqësore, inspektimi, siguria ushqimore...”
7. Programi “Menaxhimi i infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit”

8. Programi “Administrimi i pyjeve dhe kullotave”
9. Programi “Rrjeti Rrugor Rural”
10. Programi “Transporti publik”
11. Programi “Menaxhimi i mbetjeve”
12. Programi “Planifikimi urban vendor”
13. Programi “Strehimi”
14. Programi “Shërbimet publike vendore”
15. Programi “Furnizimi me ujë dhe kakalizime”
16. Programi “Shërbimet e kujdesit parësor”
17. Programi “Sport dhe argëtim”
18. Programi “Zhvillimi i sportit”
19. Programi “Trashëgimia kulturore, eventet artistike dhe kulturore”
20. Programi “Arsimi bazë (përfshirë parashkollor) ”
21. Programi “Arsimi mesëm përgjithshëm (+ konvikte)”
22. Programi “Arsimi mesëm profesional”
23. Programi “Kujdesi social”
24. Programi “Strehimi social”
25. Programi “Emergjenca civile”
26. Programi “Zgjedhjet e përgjithshme dhe vendore”
27. Programi “Fondi rezerve dhe kontigjenca”

### **Burimet e financimit të buxhetit të Bashkisë Elbasan, për vitin 2023, vijnë nga dy drejtime:**

**Nga burimet e veta vendore**, ku përfshihen të ardhurat nga taksat vendore, të ardhurat nga tarifatat vendore, të ardhura të tjera, donacione, dhe të ardhura të trashëguara.

**Nga burimet qendrore**, ku përfshihen transferta e pakushtëzuar, transferta specifike për funksionet e reja (sektoriale), transferuar Bashkisë, transferta të kushtëzuara dhe investime nga FZSH.



## II. REALIZIMI I TË ARDHURAVE TË BASHKISË NGA BURIMET E VETA VENDORE PËR VITIN 2023

Të ardhurat e veta vendore përfshijnë të ardhurat nga taksat dhe tarifat vendore, të ardhurat të tjera dhe të ardhurat nga funksionet specifike, si shërbimi pyjor, ujitja dhe kullimi, etj. Këto burime të ardhurash bashkia i përdor për financimin e funksioneve të përcaktuara nga ligji nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”. Gjatë periudhës janar- dhjetor 2023, përveç administrimit dhe dhënies së shërbimit ndaj qytetarëve në gjithë territorin e saj, Bashkia menaxhoi burimet e veta dhe siguroi të ardhurat e nevojshme për kryerjen e gjithë funksioneve.

Rëndësi e veçantë iu dha shfrytëzimit dhe vënies në efikasitet të aseteve të veta, zgjerimit të bazës taksapaguese, rritjes së nivelit të arkëtimeve nëpërmjet politikave lehtësuese, taksave të ulta dhe rritjes së frymës së konkurrencës së ndershme, thjeshtimit dhe standartizimit të procedurave, si dhe trajtimit të qytetarëve dhe bizneseve si partnerë të përbashkët të Bashkisë.

Objektivat sipas programit të kryetarit të bashkisë, kryesisht të fokusuar në lehtësimin maksimal fiskal, ndikuan në nxitjen e zhvillimit dhe zgjerimit të biznesit, duke ruajtur dhe madje duke induktuar me efikasitet rritjen e të ardhurave për zërat kryesorë që lidhen me biznesin. Gjithashtu mundësi i shlyerjes së pagesave sa më pranë taksapaguesit, dhënia e shërbimeve të përmirësuara dhe informimi i taksapaguesit nëpërmjet strukturave të bashkisë dhe agjentit tatimor Ujësjiellës Kanalizime, të shpërndara gjeografikisht në territorin e bashkisë pranë qytetarit, ndikuan në përmirësimin e vazhdueshëm të klimës së biznesit dhe marrëdhënies me taksapaguesin.

Politikat për gjendjen sa më pranë taksapaguesit nëpërmjet taksave dhe tarifave të ulëta e në harmoni me shërbimin që ofrohet, si psh: dhënia e lehtësive fiskale për shtresat familjare në nevojë, taksa në minimumin e lejuar ligjor për tokën bujqesore, etj. janë zbatuar dhe kanë rezultuar të sukseshme jo vetëm për zbutjen e vështirësive ekonomike për shtresa të veçanta të familjeve dhe reduktimin e papunësisë, por edhe për rritjen e të ardhurave krahasuar me të njëjtën periudhë të viteve të kaluara.

Këto politika të lehtësive fiskale kundrejt përmirësimit të shërbimit janë shoqëruar natyrisht me objektivin për zgjerimin e bazës së taksapaguesve. Masat që u ndërmoren nga qeveria në mbrojtje të shëndetit të qytetarëve bënë që gjatë këtij viti të kishte përmirësime në vijimin normal të procesit të arkëtimeve të të ardhurave dhe niveli i arkëtimeve të ishte në rritje.

Të ardhurat e veta u realizuan në proces dhe bashkëpunim me gjithë administratën e Bashkisë, me Njësitë Administrative, me institucionet si agjentë tatimorë, institucionet shtetërore etj. Ndërsa periudha shkurt pati një ulje të nivelit të të ardhurave krahasuar me muajin janar, në muajt e tjerë pasardhës reflektohet tendencë në rritje. Kulmi i arkëtimeve ishte në muajt korrik dhe gusht. Në muajin shtator kemi rënie të nivelit të arkëtimeve. Në muajin tetor reflektohet rritje

deri në nivel mesatar, tendence e cila shtrihet deri në fund te vitit, siç edhe tregohet në grafikun më poshtë.

## ➤ KATEGORIZIMI I TË ARDHUARAVE

Taksat vendore:

- Taksa mbi pasurinë e paluajtshme, për ndërtesa, troje dhe toka bujqësore
- Taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja
- Taksa mbi veprimtarinë e shërbimit hotelier
- Taksa e tabelës për qëllime reklamimi ose identifikimi
- Tatimi thjeshtuar mbi fitimin, biznesi vogël nga 5 milion deri ne 8 milion,

Taksat e ndara:

- Taksa mbi kalimin e të drejtës së pronësisë,
- Taksa vjetore e mjeteve të përdorura,
- Të ardhura pjesore nga taksa e rentës minerare
- Të ardhura pjesore nga tatimi mbi të ardhurat personale

Tarifat vendore:

- Tarifa e pastrimit dhe largimit të mbeturinave
- Tarifa për ndriçimin publik
- Tarifa për gjelbrimin
- Tarifa të shërbimit administrativ të bashkisë Elbasan
  
- Tarifa për parkimin e mjeteve e liçensuara dhe vendparkime publike
- Tarifat e shërbimeve që kryen struktura e mbrojtjes nga zjarri
- Tarifa për zënien e hapësirave publike
- Tarifa nga Institucionet e arsimit, kulturës, sportit etj.

Të ardhura të tjera:

- Të ardhura nga gjoba
- Të ardhura nga dhënia me qira e aseteve, zhdëmtime, shitja e aseteve dhe e shërbimeve etj.


Të ardhura nga huaja:

➤ **Të ardhurat nga burimet e veta të Bashkisë për vitin 2023**

në mijë lekë

<b>N r.</b>	<b>Të ardhurat nga burimet e veta vendore</b>	<b>Plan viti 2023</b>	<b>Fakt janar – dhjetor 2023</b>	<b>Realizimi %</b>
<b>1</b>	Të ardhurat nga taksat	719,282	295,050	<b>41%</b>
<b>2</b>	Të ardhura nga taksat e ndara	119,500	140,935	<b>117%</b>
<b>3</b>	Te ardhurat nga tarifat	546,363	366,469	<b>67%</b>
<b>4</b>	Te ardhura te tjera	337,526	123,372	<b>36%</b>
<b>5</b>	Te ardhura nga donacionet (jasht limiti)	0		
	<b>TOTALI</b>	<b>1,722,671</b>	<b>932,754</b>	<b>54%</b>

## Të ardhurat e realizuara sipas kategorive për vitin 2023



- ▣ Të ardhurat nga taksat vendore
- ▣ Të ardhura nga taksat e ndara
- ▣ Te ardhurat nga tarifat vendore
- ▣ Te ardhura te tjera
- ▣ Te ardhura nga donacionet (jasht limiti)


në mijë lekë

Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht
64,831	56,853	60,861	53,942	76,011	81,438	125,954	117,309

Shtator	Tetor	Nentor	Dhjetor	Vjetor
61,704	78,189	77,068	78,594	932,754

Paraqitja grafike:

## Arkëtimi i të ardhurave per vitin 2023



➤ Realizimi i të ardhurave për periudhën Janar- Dhjetor 2023.

Në mijë lekë

Nr	Te Ardhura	PLAN VJETOR 2023	FAKT VJETOR 2023	Krahasimi ne % me planin vjetor
<b>B</b>	<b>TE ARDHURA</b>			
	<b>TE ARDH.VENDORE (I+II+III+IV+V+VI)</b>	<b>1,722,671</b>	<b>925,826</b>	<b>54%</b>
<b>I</b>	<b>TE ARDHURA NGA TAKSAT VENDORE</b>	<b>719,282</b>	<b>295,050</b>	<b>41%</b>
1	Tatimi thjeshtuar mbi fitimin e BV	3,000	1,205	40%
2	Taksa mbi ndertesat	329,962	174,231	53%
3	Taksa mbi token bujqesore	27,480	16,314	59%
4	Taksa mbi truallin	56,540	25,926	46%
5	Taksa mbi veprimtarine e sherbimit hotelier	11,000	9,567	87%
6	Taksa e ndikimit ne infrastrukture	290,000	63,692	22%
7	Taksa e tabelës	1,300	4,115	317%
<b>II</b>	<b>TE ARDHURA NGA TAKSAT E NDARA</b>	<b>119,500</b>	<b>140,935</b>	<b>118%</b>
1	Taksa mbi kalimin e te drejtes se pronesise	15,000	5,125	34%
2	Taksa vjetore e mjeteve te perdorura	70,000	78,374	112%
3	Taksa e rentes minerare	500	717	143%
4	Tatimi mbi te ardhurat personale	34,000	56,719	167%
<b>III</b>	<b>TE ARDHURA NGA TARIFAT</b>	<b>546,363</b>	<b>366,469</b>	<b>67%</b>
1	Tarife per zenien e hapesires publike	36,500	28,722	79%
2	" pastrimi	202,500	147,927	73%
3	" gjelberimi	46,900	34,372	73%
4	" ndricimi	96,000	51,064	53%
5	" mirembajtje infrastrukture ne Nj.Admin.	4,000	3,924	98%
6	" reklame	8,000	4,978	62%
7	" parkim automjete	20,000	12,231	61%
8	" embleme bashkie	60	66	110%
9	" leje, certificate transporti	2,000	2,278	114%
10	" autorizim treg. karburanti + lende djegese	9,000	24,120	268%
11	" leshimin e vertetimeve	2,283	1,700	74%
12	" autoriz., zgjatje orari ,etj	2,200	1,940	88%
13	" sherbimi karrotresh	500	18	4%
14	" leje perdorimi per objekte biznesi	24,500	1,026	4%
15	" leje perdorimi per banim	2,200	1,098	50%
16	" certifikim relievi	1,000	880	88%
17	" deklarim paraprak	4,300	1,213	28%
18	" trajt.fasades ndertesave	1,200	1,652	138%
19	" aplikim leje zhvillimi	1,500	530	35%
20	" hartim PDV per siperfaqen e prones	22,000	926	4%
21	" shqyrtim dokumenta leje ndertimi	3,000	2,578	86%
22	" kantier ndertimi per objekt mbi 4 kat	5,500	3,853	70%
23	" leshimin e dok.nga arkiva	200	67	34%
24	" rrjetin e tubacion.ujrave bardha	2,200	2,198	100%

25	" rrjetin e tubacion,ujrave zeza	290	283	98%
26	" sherbimi per rrjetin kabllor	4,500	3,322	74%
27	" uji pijshem	30	30	100%
28	" ndotjes mjedisit	26,000	23,480	90%
29	" depozitim i mbetjeve te ngurta	18,000	9,993	56%
<b>IV</b>	<b>TE ARDHURA JO-TATIMORE</b>	<b>211,681</b>	<b>50,991</b>	<b>24%</b>
1	Qera objekti	695	527	76%
2	Qera trualli (toke e pafrytshme)	4,208	2,543	60%
3	Qera toke bujqesore	310	176	57%
4	Qera toke pyjore	21,270	30,010	141%
5	Gjoha ndertimi	12,000	2,971	25%
6	Gjoha biznesi	8,460	9,910	117%
7	Te ardhura nga legalizimet	119,738	4,684	4%
8	Te ardhura nga shitja e asetëve (FK)	45,000	0	0%
9	Te ardhura nga shitja e tokes (troje,terrene)		82	
10	Te ardhura nga shitja ndertime		88	
<b>V</b>	<b>TE ARDHURA INSTITUCIONET</b>	<b>73,185</b>	<b>50,736</b>	<b>69%</b>
1	<b>Qendra Ekonomike Arsimit</b>	<b>52,535</b>	<b>32,254</b>	<b>61%</b>
	Te ardhura nga Cerdhet	11,616	6,435	55%
	Te ardhura nga kopeshitet	32,718	17,491	53%
	Te ardhura nga qerate	8,201	8,328	102%
2	<b>Te ardhura Klubi Shumesporte</b>	<b>1,030</b>	<b>1,256</b>	<b>122%</b>
	Te ardhura nga qira objekti	1,030	1,256	122%
3	<b>Qendra e Artit</b>	<b>900</b>	<b>753</b>	<b>84%</b>
	Te ardhura nga biletat	800	563	70%
	Te ardhura okupim salle	100	190	190%
4	<b>Qendra e Trashegimise Kulturore</b>	<b>120</b>	<b>247</b>	<b>206%</b>
	Te ardhura Trashegimia Kulturore	120	247	206%
	Te ardhura Biblioteka	0		
5	<b>Agjensia e Sherbimeve Publike</b>	<b>10,600</b>	<b>8,906</b>	<b>84%</b>
	Te ardhura sherbimet publike	100	0	0%
	Te ardhura M.Varreza	9,000	8,281	92%
	Tarife sherbimi per subjektet qe kryejne punime per riparimin e varreve	1,500	625	42%
6	<b>Te ardhura nga Banesat Sociale me Qira</b>	<b>8,000</b>	<b>7,320</b>	<b>92%</b>
	Te ardhura nga qirate	8,000	7,320	92%
<b>VI</b>	<b>TE ARDHURA FUNKSIONET SPECIFIKE</b>	<b>52,660</b>	<b>21,645</b>	<b>41%</b>
1	Te ardhura nga Zjarrfikesja	2,000	1021	51%
2	Te ardhura nga Sherbimi Pyjor	45,160	14855	33%
3	Te ardhura Ujitja dhe Kullimi	5,500	5769	105%
	<b>Te ardhura Jashte Limiti</b>		<b>6,928</b>	
1	grant nga keshilli qarkut		3,900	
2	takse pulle gj civile		193	
3	donacione		2,835	
	<b>Total te ardhura</b>	<b>1,722,671</b>	<b>932,754</b>	<b>54%</b>

Ne tabelën e mësipërme vërehet se të ardhurat vendore, për vitin 2023 janë realizuar në masën 54% ose në vlerë totale **932,754** mijë lekë.

Nga këto të ardhurat nga taksat vendore janë realizuar në masën **41%** ose në vlerë totale **295,050** mijë lekë.

Nga këto të ardhurat nga taksat e ndara janë realizuar në masën **118%** ose në vlerë totale **140,935** mijë lekë.

Nga këto të ardhurat nga tarifatat janë realizuar në masën **67%** ose në vlerë totale **366,469** mijë lekë.

Nga këto të ardhurat jo tatimore janë realizuar në masën **24%** ose në vlerë totale **50,991** mijë lekë.

Nga këto të ardhurat nga institucionet janë realizuar në masën **69%** ose në vlerë totale **50,738** në mijë lekë.

Nga këto të ardhurat nga funksionet specifike janë realizuar në masën **41%** ose në vlerë totale **21,645** në mijë lekë.

Në total, plani i të ardhurave për periudhën janar- dhjetor 2023 është realizuar në masën 54%.

*Në planin e të ardhurave, miratuar në buxhetin e vitit 2023, janë planifikuar "Arkëtim debitorë", për shumën 220,000 mijë lekë, i ndarë 120,000 mijë lekë detyrime të prapambetura nga familjarët (UKE) dhe 100,000 mijë lekë nga subjektet.*

*Gjatë vitit 2023 nga këto detyrime janë arkëtuar 89,790 mijë lekë, detyrime nga familjarët, nëpërmjet UKE si agjent tatimor.*

*Gjithashtu, këto detyrime janë shpërndarë në tabelën e mësipërme, plan dhe fakt, sipas zërave të taksave dhe tarifave.*




- Të ardhurat e përgjithshme në total, nga burimet e veta vendore dhe burimet qëndrore për vitin 2023.

Në mijë lekë

Të ardhurat e përgjithshme në total, nga burimet e veta vendore dhe burimet qëndrore për vitin 2023		
1	Të ardhura nga taksat dhe tarifatat vendore	925,826
2	Të ardhura nga donacione	6,909
3	Të ardhura nga transfertat e pakushtëzuar	975,562
4	Të ardhura nga transfertat sektoriale (specifike)	512,245
5	Të ardhura nga transfertat e kushtëzuar	2,297,257
6	Të ardhura të trashëguara nga viti 2022 (të ardh. veta + grante)	373,966
7	Huamarrja	2,322
8	<b>TOTALI</b>	<b>5,094,087</b>

### Të ardhurat e përgjithshme në total për vitin 2023



**Të ardhura nga taksat dhe tarifet vendore** janë realizuar 925,826 mijë lekë ose 18% e të ardhurave të përgjithshme.

**Të ardhura nga donacione** janë realizuar 6,909 mijë lekë ose 0.1% të ardhurave të përgjithshme.

**Të ardhura nga transfertat e pakushtëzuar** janë realizuar 975,562 mijë lekë ose 19 % e të ardhurave të përgjithshme.

**Të ardhura nga transfertat sektoriale (specifike)** janë realizuar 512,245 mijë lekë ose 10 % e të ardhurave të përgjithshme.

**Të ardhura nga transfertat e kushtëzuar** janë realizuar 2,297,257 mijë lekë ose 45% e të ardhurave të përgjithshme.

**Të ardhura të trashëguara nga viti 2022** janë realizuar 373,966 mijë lekë ose 7% të ardhurave të përgjithshme.

**Të ardhura nga huamarrja për vitin 2023** janë realizuar 2,322 mijë lekë ose 0,045% të ardhurave të përgjithshme.

### III. REALIZIMI I BUXHETIT VITI 2023 4 MUJORI III-të PROGRESIV

Realizimi i buxhetit të vitit 2023 është bërë duke respektuar ligjin Nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, ligjin nr.10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar, udhëzimin nr. 9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit” i ndryshuar, ligjin Nr. 84/2022, “Për buxhetin e vitit 2023“ si dhe VKB nr. 190, datë 27.12.2022 “Për miratimin e buxhetit të Bashkisë Elbasan per vitin 2023.

Shpenzimet e buxhetit për periudhën 4-Mujori i III-të 2023, nga të gjitha burimet e financimit, arritën në **4,608,571 mijë lekë**, me një nivel realizimi prej **77%**.

PROGRAMI	EMERTIMI	PLAN VJETOR 2023	FAKTI VJETOR 2023	REALIZIMI
01110	Planifikim, Menaxhim & Administrim	675,407	522,283	77%
01170	Sherbime te gjendjes civile	22,800	20,375	89%
03140	Shërbime të Policisë Vendore	38,456	32,563	85%
03280	Mbrojtja nga zjarri dhe mbrojtja civile	166,787	49,041	29%
04130	Mbeshtetje per zhvillim ekonomik	4,278	3,940	92%
04220	Shërbimet bujq., inspekt,sig.ushq dhe mbrojtja e konsumatorit	22,694	16,794	74%
04240	Menaxhimi infrastruktures Ujitjes& Kullimit	61,041	35,711	59%
04260	Administrimi i pyjeve +kullotave	119,716	58,747	49%
04520	Rrjeti rrugor rural	618,878	298,262	48%
04570	Transporti Publik	61,305	52,546	86%
05100	Menaxhimi i mbetjeve	249,709	205,106	82%
06140	Planifikimi Urban Vendor	26	26	100%
06190	Strehimi	54,017	27,450	51%
06260	Sherbime publike vendore	354,647	257,442	73%
06370	Furnizimi me uje dhe kanalizime	49,627	37,328	75%
07220	Sherbimet e kujdesit paresor	3,726	2,456	66%
08130	Sport dhe argetim	119,297	82,990	70%
08140	Zhvillimi i sportit	30,372	30,372	100%
08220	Trasheg.kulturore eventet artist.&kulturore	116,176	83,203	72%
09120	Arsimi baze&parashkollor	619,915	463,947	75%

<b>09230</b>	Arsimi Mesem Pergj. ( arsimi mesem + konvikte)	424,811	265,672	63%
<b>09240</b>	Arsimi Mesem Profesional	40,615	38,516	95%
<b>10430</b>	Perkujdesi social	2,018,685	1,951,754	97%
<b>10661</b>	Strehimi Social	36,944	26,912	73%
<b>10910</b>	Emergjencia Civile	46,529	36,749	79%
<b>01620</b>	Zgjedhjet e pergjithshme & lokale	8,464	8,386	99%
<b>04980</b>	Fondi rezerve & Kontigjenca	9,788	0	0%
	<b>TOTALI</b>	<b>5,974,710</b>	<b>4,608,571</b>	<b>77%</b>


Peshën më të madhe të realizimit në përqindje e zënë shpenzimet e personelit (paga dhe sigurime), të cilat janë realizuar në masën **92%**, ku përveç pagave të administratës bëjnë pjesë edhe pagat e punonjësve të arsimit parashkollor (edukatorët e kopështeve), punonjësit e konvikteve, punonjësit mbështetës të arsimit parashkollor dhe të mesëm, shërbimi zjarrfikës, ujitja dhe kullimi, administrimi i pyjeve dhe kullotave, etj, sipas funksioneve të cilat iu deleguan bashkive pas reformës territoriale.

Një zë i rëndësishëm janë transfertat në masën **91%** të planit ku përfshihen ndihmat ekonomike, pagesa e personave me aftësi ndryshe, financuar këto nga transfertat e kushtëzuar.

<b>EMERTIMI</b>	<b>PLAN VJETOR 2023</b>	<b>FAKTI VJETOR 2023</b>	<b>REALIZIMI</b>
<b>Paga + sigurime (600+601)</b>	1,359,712	1,254,084	92%
<b>Shpenzime operative (602+651+166)</b>	1,075,440	766,349	71%
<b>Transferta ( 604+605+606+609)</b>	2,183,265	1,978,750	91%
<b>Investime (230+231)</b>	1,356,293	609,388	45%
<b>Totali</b>	<b>5,974,710</b>	<b>4,608,571</b>	<b>77%</b>

Paraqitja grafike:

## 4 MUJORI I III-TË PROGRESIV 2023



Bazuar në shpenzimet faktike të vitit 2023 :

**Shpenzimet për paga** zënë 27% të totalit të shpenzimeve dhe janë realizuar 62% me burim financimi transfertën e pakushtëzuar dhe të ardhurat e veta, 38% me transfertë specifike dhe transfertë të kushtëzuar.

**Shpenzimet operative** zënë 17% të totalit të shpenzimeve dhe janë realizuar 91% me burim financimi transfertën e pakushtëzuar dhe të ardhurat e veta, 6% me transfertë specifike, 2% nga transferta e kushtëzuar dhe 0.5% nga nga te ardhurat jashtë limiti.

**Shpenzimet për transferime** zënë 43% të totalit të shpenzimeve dhe janë realizuar 3% me transfertë të pakushtëzuar dhe të ardhurat e veta dhe 97% me burim financimi transfertën e kushtëzuar.

**Shpenzimet për investime** zënë 13% të totalit të shpenzimeve dhe janë realizuar 59% me burim financimi transfertën e pakushtëzuar dhe të ardhurat e veta, 36.5% me transfertë specifike, dhe 3.5% me burim financimi nga transferta pakushtëzuar sektoriale dhe 1% me burim financimi të ardhurat jashte limiti.

Realizimi i shpenzimeve për 4 Mujorin e III-të(progresive), viti 2023 (nga të gjitha burimet e fondeve)

në mijë lekë

Programi	kod/Programi	Shpenzime personeli		Shpenzime operative		Transferita+ bvencione		Shpenzime Kapitale		Total buxheti		
		plan	fakt	plan	fakt	plan	fakt	plan	fakt	plan	fakt	
1	Planifikim, Menaxhim & Administrim	01110	377,469	367,198	188,231	144,423	28,387	10,662	81,320	675,407	522,283	
2	Sherbime te gjendjes civile	01170	20,712	20,069	1724	191	46	46	318	22,800	20,375	
3	Shërbime të Policisë Vendore	03140	35,326	32,203	3,000	230	130	130		38,456	32,563	
4	Mbrojtja nga zjarri dhe mbrojtja civile	03280	38,758	34,491	7,310	5,952	102,623	1,120	18,096	166,787	49,041	
5	Mbeshtetje per zhvillim ekonomik	04130	3,678	3,340	600	600				4,278	3,940	
6	Shërbimet bujq., inspekt.sig.ushq dhe mbrojtja e konsumatorit	04220	14,302	13,602	200		68	68	8,124	22,694	16,794	
7	Menaxhimi infrastruktures Ujijes& Kullimit	04240	21,902	18,537	16,685	9,741	68	68	22,386	61,041	35,711	
8	Administrimi i pyjeve +kullotave	04260	29,675	25,269	42,317	19,389			47,724	119,716	58,747	
9	Rrjeti rrugor rural	04520	88,792	84,906	41,012	24,319	2,285	365	486,789	618,878	298,262	
10	Transporti Publik	04570	6,060	5,767	20,545	14,584	5,000	2495	29,700	61,305	52,546	
11	Menaxhimi i mbejtjeve	05100	19,843	18,393	228,333	185,389			1,533	249,709	205,106	
12	Planifikimi Urban Vendor	06140							26	26	26	
13	Strehimi	06190					24,432	22,815	29,585	54,017	27,450	
14	Sherbime publike vendore	06260	71,193	67,405	230,149	150,687	548	548	52,757	354,647	257,442	
15	Furnizimi me uje dhe kanalizime	06370							49,627	49,627	37,328	
16	Sherbimet e kujdesit pasesor	07220	3,026	1,958	700	498				3,726	2,456	
17	Sport dhe argetim	08130	32,516	29,651	32,361	29,192	18,705	17,198	35,715	119,297	82,990	
18	Zhvillimi i sportit	08140							30,372	30,372	30,372	
19	Trasheg.kulturore eventet artist.&kulturore	08220	52,670	50,504	41,946	32,455	80	58	21,480	116,176	83,203	
20	Arsimi baze&parashkollor	09120	402,568	342,982	121,657	81,309	1,943	1,725	93,747	619,915	463,947	
21	Arsimi Mesem Pergi. ( arsimi mesem + konvikte)	09230	51,017	50,214	40,553	24,834	175	175	333,066	424,811	265,672	
22	Arsimi Mesem Profesional	09240			4,561	1,409	39,054	37,107		40,615	38,516	
23	Perkujdesi social	10430	76,767	74,613	38,926	28,035	1,900,262	1,847,539	2,730	2,018,685	1,951,754	
24	Strehimi Social	10661	3,790	3,341	16,894	12,447	15,960	10837	300	36,944	26,912	
25	Emergjencia Civile	10910	1,920	1,920			33,711	25,794	10,898	46,529	36,749	
26	Zgjedhjet e pergjithshme & lokale	01620	7728	7,721	736	665				8,464	8,386	
27	Fondi rezervet & Kontigjencia	04980					9,788			9,788	0	
<b>TOTALI</b>			<b>1,359,712</b>	<b>1,254,084</b>	<b>1,075,440</b>	<b>766,349</b>	<b>2,183,265</b>	<b>1,978,750</b>	<b>1,356,293</b>	<b>609,388</b>	<b>5,974,710</b>	<b>4,608,571</b>

Realizimi i shpenzimeve për 4 Mujorin e III-të, ( progresive)viti 2023 (me fonde nga burimet e veta), grant+ transfert pakushtezuar sektoriale + ardhura													ne mije leke	
Programi	kod/Programi	Shpenzime personeli		Shpenzime operative		Transferta+ subvencione		Shpenzime Kapitale		Total buxheti				
		plan	fakt	plan	fakt	plan	fakt	plan	fakt	plan	fakt			
1	Planifikim, Menaxhim & Administrim	01110	377,469	367,198	188,231	144,423	28,387	10,662	78,485	672,572	522,283			
2	Shërbime të Policisë Vendore	03140	35,326	32,203	3,000	230	130	130		38,456	32,563			
3	Mbrojtja nga zjarri dhe mbrojtja civile	03280	38,758	34,491	7,310	5,952	102,623	1,120	18,096	166,787	49,041			
4	Mbeshtretje per zhvillimin ekonomik	04130	3,540	3,202	600	600				4,140	3,802			
5	Shërbimet bujq., inspekt.sig.ushq dhe mbrojtja e konsumatorit	04220	14,302	13,602	200		68	68	8,124	22,694	16,794			
6	Menaxhimi infrastruktures Ujitjes& Kullimit	04240	21,902	18,537	16,685	9,741	68	68	22,386	61,041	35,711			
7	Administrimi i pyjeve +kullotave	04260	29,675	25,269	42,317	19,389			47,724	119,716	58,747			
8	Rrjeti rrugor rural	04520	88,791	84,906	41,012	24,319	2,285	365	486,789	618,877	298,262			
9	Transporti Publik	04570	6,060	5,767	20,545	14,584	5,000	2495	29,700	61,305	52,546			
10	Menaxhimi i mbetjeve	05100	19,843	18,393	228,333	185,389			1,533	249,709	205,106			
11	Planifikimi Urban Vendor	06140							26	26	26			
12	Sherbime publike vendore	06260	71,193	67,405	230,149	150,687	548	548	52,757	354,647	257,442			
13	Furnizimi me uje dhe kanalizime	06370							49,627	49,627	37,328			
14	Sherbimet e kujdesit patesor	07220	3,026	1,958	700	498				3,726	2,456			
15	Sport dhe argetim	08130	32,516	29,651	31,861	28,692	18,705	17,198	35,715	118,797	82,490			
16	Trasheg.kult.eventet artist.&kulturore	08220	52,670	50,504	38,546	29,567	80	58	21,480	112,776	80,315			
17	Arsimi baze&parashkollor	09120	402,568	342,982	111,244	70,896	1,943	1,725	83,795	599,550	447,624			
18	Arsimi mesem pergi( arsimi mesem + konvikte)	09230	51,017	50,214	37,790	22,071	175	175	140,622	229,604	85,316			
19	Perkujdesi social	10430	76,568	74,414	38,926	28,035	10,205	6,755	2,730	128,429	110,771			
20	Strehimi Social	10661	3,790	3,341	16,894	12,447	15,960	10837	300	36,944	26,912			



21	Fondi rezerve & Kontigjenca	04980	1,329,014	1,224,037	1,054,343	747,520	195,965	52,204	1,079,889	381,774	3,659,211	2,405,535	9,788	9,788	0
<b>TOTALI</b>															
<b>Shpenzime nga transferta e pakushtëzuar + të ardhurat për 4 Mujorin e III-të ( progresive), viti 2023</b>															
Nr	Programi	kod/Programi	Shpenzime personeli		Shpenzime operative		Transferta+ subvencione		Shpenzime Kapitale		Total buxheti		ne mije leke		
			plan	fakt	plan	fakt	plan	fakt	plan	fakt	plan	fakt	plan	fakt	plan
1	Planifikim, Menaxhim & Administrim	01110	377,469	367,198	188,231	144,423	28,387	10,662	78,485		672,572	522,283			
2	Shërbime të Policisë Vendore	03140	35,326	32,203	3,000	230	130	130		38,456	32,563				
3	Mbrojtja nga zjarri dhe mbrojtja civile	03280	4,958	1,548	710	575	102,493	990	2,307	110,468	3,292				
4	Mbeshetje per zhvill. ekonomik	04130	3,540	3,202	600	600			8,124	4,140	3,802				
5	Shërbimet bujq., inspekt.sig.ushq dhe mbrojtja e konsumatorit	04220	14,302	13,602	200					22,694	16,794				
6	Menaxhimi infrastruktures Ujitjes& Kullimit	04240	15,556	12,502	3,000	3,000	68	68	19,963	38,587	21,412				
7	Administrimi i pyjeve +kullotave	04260	15,635	11,229	40,317	18,715			47,724	103,676	44,033				
8	Rrjeti rrugor rural	04520	73,385	69,549	35,328	19,930	2,285	365	486,789	597,787	278,516				
9	Transporti Publik	04570	6,060	5,767	20,545	14,584	5,000	2495	29,700	61,305	52,546				
10	Menaxhimi i mbetjeve	05100	19,843	18,393	210,433	167,489			1,533	231,809	187,206				
11	Planifikimi Urban Vendor	06140							26	26	26				
12	Sherbime publike vendore	06260	71,193	67,405	230,149	150,687	548	548	52,757	354,647	257,442				
13	Furnizimi me uje dhe kanalizime	06370							49,627	49,627	37,328				
14	Sherbimet e kujdesit paresor	07220	3,026	1,958	700	498				3,726	2,456				
15	Sport dhe argetim	08130	32,516	29,651	31,861	28,692	18,705	17,198	35,715	118,797	82,490				
16	Trasheg.kult.eventet artist.&kulturore	08220	52,670	50,504	38,546	29,567	80	58	21,480	112,776	80,315				
17	Arsimi baze&parashkollor	09120	34,670	30,115	111,244	70,896	1,708	1,490	83,795	231,417	134,522				
18	Arsimi mesem pergj(arsimi mesem + konvikte)	09230	525	0	25,355	14,851			95,045	120,925	15,331				
19	Perkujdesi social	10430	60,310	58,156	33,286	22,395	10,130	6,680	2,730	106,456	88,798				
20	Shtrehi Social	10661	3,790	3,341	16,894	12,447	15,960	10,837	300	36,944	26,912				
21	Fondi rezerve & Kontigjenca	04980					9,788			9,788	0				
<b>TOTALI</b>			<b>824,774</b>	<b>776,323</b>	<b>990,399</b>	<b>699,579</b>	<b>195,350</b>	<b>51,589</b>	<b>1,016,100</b>	<b>360,576</b>	<b>3,026,623</b>	<b>1,888,067</b>			

Shpenzime nga transferta pakushtëzuar sektoriale për 4 Mujorin e III-të, (progresive),viti 2023

ne mijë leke

Nr	Programi / Njesite Shpenzuese	Programi		Shpenzime personeli		Shpenzime operative		Transferta		Shpenzime Kapitale		Total buxheti	
		plan	fakt	plan	fakt	plan	fakt	plan	fakt	plan	fakt	plan	fakt
1	Mbrojtja nga zjarri dhe mbrojtja civile	33,801	32,943	6,600	5,377	130	130	15,789	7,299	56,320	45,749		
2	Menaxhimi infrastruktures Ujitjes& Kullimit	6,346	6,035	13,685	6,741			2,423	1,523	22,454	14,299		
3	Administrimi i pyjeve +kullotave	14,040	14,040	2,000	674					16,040	14,714		
4	Rrjeti rrugor rural	15,406	15,357	5,684	4,389					21,090	19,746		
5	Menaxhimi i mbetjeve			17,900	17,900					17,900	17,900		
5	Arsimi baze & parashkollor	367,898	312,867			235	235			368,133	313,102		
6	Arsimi mesem pergj.(arsimi mesem + konvikte)	50,492	50,214	12,435	7,220	175	175	45,576	12,376	108,678	69,985		
7	Pekujdesi social	16,258	16,258	5,640	5,640	75	75			21,973	21,973		
	<b>TOTALI</b>	<b>504,241</b>	<b>447,714</b>	<b>63,944</b>	<b>47,941</b>	<b>615</b>	<b>615</b>	<b>63,788</b>	<b>21,198</b>	<b>632,588</b>	<b>517,468</b>		

**Shpenzime nga transferata e kushtezuar për 4 Mujorin e III-të  
(progresive) viti 2023**

Nr	Programi / Njesite Shpenzuese	Programi	Shpenzime personeli		Shpenzime operative		Transferata		Shpenzime Kapitale		Total buxheti		ne mije leke
			plan	fakt	plan	fakt	plan	fakt	plan	fakt	plan	fakt	
1	Bashkia Elbasan(QKR)	04130	138	138							138	138	138
2	Gjendje civile	01170	20,712	20,069	687		46	46			21,445	20,115	20,115
3	Sprehimi	06190					24,432	22,815	29,585	4,635	54,017	27,450	27,450
4	Zhvillimi i sportit	08140									30,372	30,372	30,372
5	Arsimi bazë & parashkollor	09120			10,413	10,413					10,413	10,413	10,413
6	Arsimi mesem pergjithshem	09230			2,763	2,763			192,444	177,593	195,207	180,356	180,356
7	Arsimi mesem Profesional	09240			1,561	1,409	39,054	37,107			40,615	38,516	38,516
8	Ndihma ekonomike +PAK	10430					1,885,713	1,836,932			1,885,713	1,836,932	1,836,932
9	Viktimat e dhunes + projekte	10430					4,344	3,852			4,344	3,852	3,852
10	Emergjencia civile	10910	1,920	1,920			33,711	25,794	10,898	9,035	46,529	36,749	36,749
11	Zgjedhje te pergjithshme & lokale	01620	7,728	7,721	736	665					8,464	8,386	8,386
<b>TOTALI</b>			<b>30,498</b>	<b>29,848</b>	<b>16,160</b>	<b>15,250</b>	<b>1,987,300</b>	<b>1,926,546</b>	<b>263,299</b>	<b>221,635</b>	<b>2,297,257</b>	<b>2,193,279</b>	<b>2,193,279</b>

**Shpenzime nga te Ardhurat jashte Limiti për 4 Mujorin e III-të  
(progresive), viti 2023**

Nr	Programi / Njesite Shpenzuese	Programi	Shpenzime personale		Shpenzime operative		Transferta		Shpenzime Kapitale		Total buxheti		ne mije leke
			plan	fakt	plan	fakt	plan	fakt	plan	fakt	plan	fakt	
1	Planifikim, Menaxhim & Administrim	01110			0				2,835		2,835		0
2	Sherbime te gjendjes civile	01170			1,037	191			318	69	1,355		260
3	Arsimi baze & Parashkollor	09120							9,953	5,910	9,953		5,910
4	Sport & Argetim	08130			500	500					500		500
5	Trasheg.kult.eventet artist.&kulturore	08220			3,400	2,888					3,400		2,888
6	Perkujdesi social	10430	199	199							199		199
	<b>TOTALI</b>		<b>199</b>	<b>199</b>	<b>4,937</b>	<b>3,579</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>13,106</b>	<b>5,979</b>	<b>18,242</b>		<b>9,757</b>

**A) Realizimi i shpenzimeve me burim financimi transfertën e pakushtëzuar dhe të ardhurat e veta vendore.**

Këto burime të ardhurash zënë një vënd kryesor në buxhetin e bashkisë pasi financojnë pothuajse të gjitha funksionet në administrim të vetëqeverisjes vendore, të përcaktuara nga ligji 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” dhe përbëjnë 51% të totalit të buxhetit.

Gjatë vitit 2023, përveç administrimit dhe dhënies së shërbimit ndaj qytetarëve në gjithë territorin e saj, bashkia menaxhoi në mënyre racionale burimet e veta dhe siguroi të ardhurat e nevojshme për kryerjen e funksioneve bazike dhe veçanërisht atyre sociale.


**Të dhënat ekonomike:**

<b>Emertimi</b>	<b>PLAN VJETOR 2023</b>	<b>FAKTI VJETOR 2023</b>	<b>REALIZIMI %</b>
<b>Paga dhe Sigurime</b>	1,329,014	1,224,037	92%
<b>Shpenz. Operative</b>	1,054,343	747,520	71%
<b>Transferime</b>	195,965	52,204	27%
<b>Investime</b>	1,079,889	381,774	35%
<b>TOTALI</b>	<b>3,659,211</b>	<b>2,405,535</b>	<b>66%</b>

Totali i shpenzimeve buxhetore të realizuara me burimet e veta, krahasuar me planin vjetor është **66%**, ose ne vlerë **2,405,535** mijë lekë. Pagat janë realizuar në masën **92%**, ose ne vlerë **1,224,037** mijë lekë. Shpenzimet operative janë realizuar në masën **71%**, ose ne vlerë **448,825** mijë lekë. Transferimet janë realizuar në masën **18%** ose ne vlerë **747,520** mijë lekë dhe investimet janë realizuar në masën **35%**, ose ne vlerë **381,774** mijë lekë

Paraqitja grafike:

**SHPENZIMEVE ME BURIM FINANCI MI E TRANSFERTËN E PAKUSHTËZUAR  
DHE TË ARDHURAT E VETA VENDORE 2023**



**Fondi reserve** në buxhetin e vitit 2023 është planifikuar në shumën 10,000 mijëlekë, ndërsa fondi i kontigjencës 10,000 mijë lekë.

Gjatë vitit 2023 fondi rezerve është përdorur për shumën 212 mijë lekë, me vendimet e KB nr.72, datë 13.09.2023 dhe nr.92, datë 05.10.2023, për shpenzime të parashikuara në Qendrën Ekonomike të Arsimit.

Fondi I Kontigjences është përdorur plotësisht me vendim të KB nr.77, datë 13.09.2023 për shumën 10,000 lekë, për rritjen e nivelit të pagave të administratës, në zbatim të VKM -së nr.328, datë 31.05.2023.

**Fondi I emergjencave civile**, në buxhetin e vitit 2023 është planifikuar në shumën 103,623 mijë lekë dhe gjatë periudhës janar-dhjetor 2023 është përdorur 4,2% e tij, në zbatim të VKM nr.329, datë 16.05.2012 për mbulimin e dëmeve të shkatuara nga fatkeqsi natyrore dhe fatkeqsi të tjera, të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore, përkatësisht :

-3,153 mijë leke me vendime të Këshillit Bashkiak për rëmtimebanesash, shkaktuarnga fatkeqsinatyrore si rrëshqitje të tokës, si dhe për dëmtime nga rënia e zjarrit,


- 1,200 mijë lekë për rast emergjencë civile për “Riparimin e urës mbi Përroin e Kurtit në Njësinë Administrative Labinot Mal”, sipas VKB nr.33, datë 28.03.2023.

Gjithsej, gjatë vitit 2023 fondi I emergjencave civile është prekur për shumën 4 353 mijë lekë.

### Investimet nga të ardhurat dhe transferta e pakushtëzuar:

Sipas detajimit të buxhetit dhe depozitimit në sistemin e Thesarit, janë planifikuar **211,349** mijë lekë nga transferta e pakushtëzuar, **8,000** lekë nga transferta sektoriale (specifike), **193,327** mijë lekë nga fondet e trashëguara nga viti 2022, nga të ardhurat e vitit 2023 janë **581,113** mijë lekë dhe të ardhura nga huaja **86,100** mijë lekë, gjithsej mijë lekë, **gjithsej 1,079,889** mijë leke.

Paraqitja grafike:



Rreth 54% e investimeve financohen nga të ardhurat e vitit, duke bërë që prokurimi dhe realizimi i tyre të varet shumë nga arkëtimi dhe realizimi i planit të të ardhurave nga taksat dhe tarifatat vendore. Rreth 19 % të investimeve financohen me transfertë të pakushtëzuar dhe 0,7 % me transferte specifike. Të ardhurat e trashëguara financojnë rreth 18% të investimeve dhe 8 % zënë shpenzimet për shpronësime nga huaja.

Investimet (shpronësimet) nga huaja nuk janë realizuar për mungesë të dokumentacionit për shpronësim.

## **B) Realizimi i shpenzimeve me burim financimi transfertën specifike**

Në vitin 2023 Bashkia vazhdon të kryejë funksionet e transferuara me burim financimi transfertën sektoriale (specifike). Funksionet që u transferuan në Bashki janë:

### **i. Personeli mësimor dhe jomësimor në arsimin parashkollor dhe personeli jomësimor në arsimin parauniversitar.**

